

## NDALIMI ABSOUT I TORTURËS DHE KEQTRAJTIMIT

Në fjalët e përsëritura shpesh të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, *Neni 3 mishëron një nga vlerat më themelore të shoqërisë demokratike.*

*Neni 3 të Konventës percakton se: "Askush nuk vihet nën torturë ose trajtim ose ndëshkim çnjerëzor ose poshtërues."*

Është miratuar një gamë e gjerë e normave ndërkombëtare për të luftuar plagët që shkakton tortura: që nga Neni 5 i Deklaratës Unversale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948 ku thuhet se "askush nuk duhet t'i nënshtrohet tortures ose trajtimit apo dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues" e deri tek Statuti i Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale të vitit 1998 që deklaroi se tortura që ushtrohet si pjesë e dhunës së përhapur gjerësisht ose sistematike kundër civilëve përbën krim kundër njerëzimit.

Përveç Konventës, shumica e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës janë gjithashtu palë në traktatet e mëposhtme të cilat që të gjitha ndalojnë torturën.

- të katër Konventat e Gjenevës së 1949-ës,
- Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike e vitit 1966, Neni 7: "Askush nuk do t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues",
- Konventa kundër Torturës e Trajtimeve apo Dënimeve të tjera Mizore Çnjerëzore ose Poshtëruese e Kombeve të Bashkuara e 1948,
- Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese.

Ndalimi i torturës konstatohet gjithashtu në gati të gjitha sistemet ligjore kombëtare. Përfshirja e ndalimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor e poshtërues në nivel kushtetues përbën një element të rëndësishëm për të siguruar që një qëndrim i tillë mbi ndalimin e torturës të mos ndodhë brenda juridiksionit të një shteti.

Pavarësisht nga pajtueshmëria zhgënjyese me anë të të cilës raportet e besueshme dëshmojnë se tortura vazhdon të ndodhë në të gjithë botën, ndalimi mbi torturën nuk është vetëm një ndalim në përmbajtje të Konventës, por është gjithashtu pjesë e së drejtës ndërkombëtare zakonore dhe konsiderohet të jetë *jus cogens*<sup>1</sup>.

Do të ishte e gabuar të sygjerohej se vënia në zbatim e Nenit 3 bazohet kryesisht në nevojën për të luftuar vetëm fenomenin e torturës. Rastet e torturës janë aktualisht format më të rënda dhe më akute të shkeljes së Nenit 3, por mbrojtja që siguron Neni 3 është kundër llojeve të ndryshme të dhunës kundër dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik.

---

<sup>1</sup> Shih Prosecutor kundër Furundzija, 10 Dhjetor 1998, çështja Nr.IT- 95-17/I-T; Prosecutor kundër Delaïc dhe të Tjerë, 16 Nëntor 1998, çështja Nr.IT-96-21-T, 454;

Fakti nëse sjellje apo akte specifike në të vërtetë kanë rezultuar në shkelje të Nenit 3 e që duhen përcaktuar në bazë të testeve subjektive e objektive. Neni 3 përmban si aspektet substantive ashtu edhe ato procedurale, si për shembull detyrimin për të hetuar mbi supozimet *prima facie* ndaj torturës së ushtruar e trajtimeve të tjera çnjerëzore. Neni 3 mund të çenohet si nga keqtrajtimet e paramenduara e gjithashtu nga neglizhenca apo pasiviteti në ndërmarrjen e hapave specifikë ose mospasigurimi i standarteve të duhura të përkujdesit.

Neni 3 imponon si detyrime negative ashtu edhe detyrime pozitive: domethënë një detyrim për të mos kryer një vepër të caktuar, dhe detyrimet për të ndërmarrë hapa pozitivë për t'u siguruar individëve respektimin e të drejtave të tyre dhe për t'i mbrojtur ata nga keqtrajtimi.

### **Qëllimi i Nenit 3: Rregulli *de minimis***

Jo të gjitha llojet e keqtrajtitit merren në shqyrtim sipas qëllimit të Nenit 3. Gjykata që në fillim e ka bërë të qartë se keqtrajtimi duhet të mbartë në vetvete një nivel minimal të shkallës së ashpërsisë nëse duhet shqyrtuar në bazë të qëllimit të Nenit 3. Megjithatë, është njohur fakti se është i vështirë të përcaktohet ndonjëherë kufiri midis trajtimit çnjerëzor nga njëra anë, dhe një shkeljeje sipas Nenit 3 nga ana tjetër.

Në marrjen e vendimit për Nenin 3 në çështjen *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata bëri të qartë se përcaktimi i nivelit minimal të shkallës së ashpërsisë së keqtrajtitit është relativ: ai varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, si për shembull kohëzgjatja e trajtimit, efektet fizike dhe mendore të keqtrajtitit, dhe në disa raste gjinia, moshja dhe gjendja shëndetësore e viktimës<sup>2</sup>.

Në *Soering*, Gjykata shtoi se shkalla e ashpërsisë së trajtimit “varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, si për shembull natyra dhe konteksti i trajtimit ose dënimit, mënyra dhe metoda e vënies në fuqi” si dhe faktorët e mësipërm<sup>3</sup>.

Sistemi i Strasburgut më parë ka njohur faktin se çfarë klasifikohet si keqtrajtim i papranueshëm mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin. Komisioni vërejt:

*Duket nga dëshmia e një numër dëshmitarësh se një shkallë ashpërsie e trajtimit të të burgosurve si nga policia, ashtu edhe nga autoritetet ushtarake tolerohet nga shumica e tyre e madje edhe pranohet. Kjo nënvizon faktin se kufiri që të burgosurit ose publiku pranojnë dhunën fizike si jo të dëmshme ose të tepruar, ndryshon midis shoqërive të ndryshme dhe madje edhe niveleve të ndryshme që i përkasin këtyre shoqërive<sup>4</sup>.*

Çështja shtrohet kur shoqëri të ndryshme, dhe në fakt, individë që i përkasin një shoqërie të caktuar kanë perceptime të ndryshme mbi faktin se çfarë përbën keqtrajtimin. Një trajtim specifik që drejtohet kundër grave ose femijëve për shembull, duke marrë parasysh besimin fetar e bazat kulturore, mund të konsiderohet si më i rëndë nga disa grupe se disa të tjerë. Shkalla e efekteve psikologjike që shkakton një trajtim i dhënë mbi

<sup>2</sup> *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 18 Janar 1978, Seria A nr.25.

<sup>3</sup> *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, gjykim i 7 Korrikut 1989, Seria A nr. 161,100.

<sup>4</sup> Çështja *Greke*, 5 Nëntor 1969, YB XII, faqja 501.

një individ shpesh do të varet në kulturën e një individi. Megjithatë, në fushën e keqtrajtimit dhe mbrojtjes së siguruar nga Neni 3, është i dukshëm fakti se bashkimi në rritje i standarteve dhe praktikave çon në më tepër objektivitet në vlerësimin e kufirit të shkallës minimale të shkaktuar nga një keqtrajtim<sup>5</sup>.

### **Përkufizim**

Të tre fushat e gjera të ndalimit në Nenin 3 janë përshkruar si të dallueshme nga njëra tjetra, por që kanë lidhje. Sipas Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut në *Çështjen Greke, Është e qartë se mund të ushtrohet trajtim i tillë për të cilin mund të zbatohen të gjitha përshkrimet, pasi tortura duhet të konsiderohet si çnjerzore dhe trajtim poshtërues, dhe trajtimi çnjerëzor gjithashtu mund të konsiderohet si poshtërues.*

Në mënyrë që të kuptohet se cila lloj sjelljeje ndalohej, dhe sesi duhet klasifikuar ajo sjellje, është e rëndësishme që të kuptohet se cilat janë supozimet ligjore për cilindo term të parashtruar në Nenin 3.

Neni 3 mund të ndahet në pesë elementë:

- tortura
- çnjerzore
- poshtëruese
- trajtim
- ndëshkim

### **Tortura**

Gjykata ka shprehur pikëpamjen se qëllimi i hartuesve të Konventës kur kanë përdorur të dy termat “torturë” dhe “trajtim çnjerëzor ose poshtërues” ka qenë që të bënin një dallim të qartë ndërmjet tyre<sup>6</sup>.

Më konkretisht, Gjykata ka konsideruar se qëllimi ishte që t’i bashkëngjitej një ndjenjë turpi trajtimit të qëllimshëm çnjerëzor që shkakton vuajtje shumë të rënda e mizore<sup>7</sup>.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, megjithëse ka identifikuar elementët që karakterizojnë trajtimin ose dënimin si torturë, asnjëherë nuk është përpjekur që të përcaktojë qartë se çfarë nënkupton ky term. Megjithatë, ajo ka mbështetur pjesërisht përkufizimin e dhënë në Konventën kundër Torturës së Kombeve të Bashkuara që hyri në fuqi më 26 qershor 1987. Në Nenin 1 Konventa deklaroi se *Termi torturë nënkupton çdo akt me anë të të cilit shkaktohet qëllimisht dhimbje ose vuajtje e rëndë, qoftë fizike apo mendore mbi një person për qëllime të tilla që të përftohet prej tij apo një person tjetër një informacion ose rrëfim duke e ndëshkuar atë për një akt që ai ose një person i tretë ka kryer ose dyshohet se ka kryer, ose duke e frikësuar ose detyruar atë ose një person të tretë, ose për ndonjë arsye të bazuar në diskriminim të çfarëdo lloji.*

---

<sup>5</sup> Prezantimi i standarteve të përbashkëta të pranueshme, veçanërisht në lidhje me\ trajtimin e të ndaluarve të të gjitha llojeve, refl ektohet më mirë në Raportet e Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe raportet e saj dhe rekomandimet mbi praktikën më të mira.

<sup>6</sup> Shih citime të kohëve të fundit si për shembull *Dikme kundër Turqisë* gjykimi i 11 Qershorit 2000,

<sup>7</sup> Ibid. 167

Nga sa më sipër është e mundur që të nxirren tre *elementë thelbësorë* që përbëjnë *torturën*:

- shkaktimi i dhimbjeve ose vuajtjeve mendore ose fizike
- shkaktimi i qëllimshëm apo i paramenduar i dhimbjeve
- ndjekja e një qëllimi specifik, si për shembull, përcimi i informacionit, dënimit apo frikësimit.

Në çështjen e parë që organeve të Konventës iu desh t'iu drejtoheshin një ankimi ndaj tortures kishte të bënte me një çështje ndërshtetërore kundër Greqisë për praktikën e kryera nga diktatura ushtarake që udhëhiqte Greqinë në atë kohë. Komisioni ishte i vetmi organ që hetonte për pretendimet, pasi në atë kohë qeveria greke denoncoi Konventën menjëherë pas fillimit të hetimeve nga ana e tij. Megjithatë Komisioni konstatoi se ishin zbatuar praktika që kishin shkaktuar *falanga* (rrahje e thembrave të këmbës me një instrument fortë), rrahje të rënda, trajtim me elektroshok, ekzekutime të stimuluar dhe kërcënime për të qëlluar dhe vrarë viktimat. Komisioni nxorri përfundimin se kishin ndodhur si akte torture, ashtu edhe keqtrajtimi.

Në çështjen e dytë ndërshtetërore, *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Komisioni kishte konstatuar në mënyrë unanime se përdorimi i kombinuar i të ashtuquajturave “pesë teknikave” në çështjen e parashtruar, të ashtuquajtur “disorientim” ose “privim sensorial”, përbënte një praktikë të trajtimit çnjerëzor dhe të tortures duke cënuar Nenin 3. Të ashtuquajturat “pesë teknika” ishin qëndrimi pas murit: kur detyrohen të disa orësh në “pozicion tensionues”, i përshkruar nga ata që i janë nënshtruar një teknike të tillë si “*të mbështetur me duar lart e kokën pas murit*, e me këmbë të hapura e të përthyera duke i bërë ata të qëndronin në majë të gishtave ku pesha e trupit varej në atë të gishtërinjve”; *të mbuluar*: vendosja e një çante të zezë ose të errët në kokën e të ndaluarve dhe, të paktën si fillim i linin ata ta mbanin atë gjatë gjithë kohës përveçse gjatë marrjes në pyetje;

*nënshtrimi ndaj zhurmës*: pezullimi i marrjes në pyetje, mbajtja e të ndaluarve në një dhomë ku bëhet një zhurmë e vazhdueshme, e lartë dhe tingëlluese;

*privimi nga të fjeturit*: pezullimi i marrjes në pyetje, privimi i të ndaluarve nga gjumi;

*privimi nga marrje e ushqimit dhe pijes*: të ndaluarit i nënshtrohen një diete të reduktuar gjatë qëndrimit të tyre në ndalim dhe i pezullohet marrja në pyetje.

Megjithatë, Gjykata nuk ra dakort me Komisionin dhe me një shumicë, ku trajtimi klasifikohet më shumë si çnjerëzor sesa torturë. Gjykata konstatoi se, meqë pesë teknikat ishin zbatuar në kombinim me paramendim dhe me katër orë për çdo herë, ato shkaktuan të paktën vuajtje intensive fizike dhe mendore personave që iu nënshtruan atyre dhe gjithashtu çuan në shqetësime akute psikike gjatë marrjes në pyetje. Kështu, çështja i përkiste kategorisë së trajtimit çnjerëzor brenda kuptimit të Nenit 3. Teknikat ishin gjithashtu poshtëruese pasi nxitën ndjenjën e frikës, ankthit dhe inferioritetit të viktimave duke i poshtëruar e ulur ata e mundësisht duke thyer rezistencën e tyre fizike apo morale. Megjithatë, ata nuk i ishin nënshtruar kuptimit të dhënë nga termi torturë që nënkuptonte trajtimin *e ashpër e mizor*.

## Qëllimi

Në *Aksoy kundër Turqisë*, në vendimin e saj paraprak mbi faktin se një individ është torturuar, Gjykata vërejtë se “ky trajtim mund të ishte shkaktuar vetëm qëllimisht”. Gjykata vijoi duke thënë se në fakt “nevojitej një shkallë përgatitjeje e ushtrimit për të kryer atë”. Trajtimi në fjalë konsistonte në të ashtuquajturin “varje Palestineze” ku viktima varet nga krahët e lidhura nga pas.

Kohët e fundit, në *Dikme kundër Turqisë* Gjykata po ashtu konstatoi se trajtimi i shkaktuar mbi viktimën konsistoi në “të paktën një numër të madh grushtash dhe formave të ngjashme të torturës”. Gjykata konsideroi se një trajtim i tillë ishte kryer qëllimisht nga agjentët e Shtetit ndaj aplikantit gjatë përmbushjes së detyrave të tyre.

### **Synimi**

Fjala *torturë* përdoret shpesh për të përshkruar trajtimin çnjerëzor që ka një synim, si për shembull marrjen e një informacioni ose rrëfimeve duke shkaktuar ndëshkime. Gjykata ka vërejtur në një sërë çështjesh se elementi i synimit të shkaktimit të torturës njihet në përcaktimin e termit torturë në Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1987, dhe se ky përkufizim i referohet torturës në lidhje me shkaktimin e dhimbjeve të rënda qëllimisht ndaj një personi me synimin, ndërmjet të tjerash, për të marrë informacion, duke shkaktuar ndëshkime ose frikësuar viktimën.

### **Actus reus**

Çështja e parë ku Gjykata ka deklaruar se është ushtruar torturë ishte *Aksoy kundër Turqisë*, ku viktima i ishte nënshtruar “varjes Palestineze”, më fjalë të tjera, ai ishte lakuriq i varur nga krahët krahët e lidhura nga mbrapa. Kjo çoi në paralize të krahëve që i zgjati për disa kohë. Shkalla e ashpërsisë dhe mizore e një trajtimi të tillë rezultoi se mund konsiderohej si torturë nga Gjykata.

Në *Aydin kundër Turqisë*, Kërkuesja pretendonte, ndërmjet të tjerave, se ishte përdhunuar gjatë masës së ndalimit. Gjykata, për të gjetur provat që ajo vërtet ishte përdhunuar deklaroi se

*Përdhunimi i një të ndaluarit nga një zyrtar i Shtetit duhet të konsiderohet veçanërisht si një formë e rëndë dhe e pështirë e keqtrajtimi, t duke pasur parasysh që shkelësi i ligjit ka shfrytëzuar lehtësinë që i krijohet për shkak të dobësisë dhe rezistencës së dobët që mund të haset nga viktima. Gjithashtu, përdhunimi lë shenja të thella psikologjike tek viktima që nuk zbuten aq lehtë me kalimin e kohës, ashtu si ndodh me format e tjera të dhunës fizike e mendore.*

Gjykata vijoi duke thënë se përdhunimi konsiderohet formë torturë duke cënuar Nenin 3 të Konventës. Në *Selmouni kundër Francës* Kërkuesi ishte nënshtetas hollandez dhe maroken i burgosur në Francë. Kërkuesi iu nënshtrua një numri të madh gjuajtjesh me grushta gati në të gjithë trupin. Ai ishte tërhequr zvarrë nga floket dhe e kishin detyruar të vraponte në një korridor me policë nga të dyja anët për ta penguar atë; ishte detyruar të gjunjëzohej përparë një gruaje të re të cilës dikush i tha: “Shiko do të dëgjosh dikë të këndoje”; kishin urinuar mbi të; dhe ishte kërcënuar me një llampë me korrent dhe më pas me një shiringë. Gjykata vërejtë se këto akte nuk ishin vetëm të dhunshme, por ato do të ishin të tmerrshme e poshtëruese për këdo *pavarësisht nga kushtet e tyre*. Elementi i kohëzgjatjes u mor gjithashtu në konsideratë në këtë çështje, dhe gjithashtu fakti se ngjarjet e mësipërme nuk kufizoheshin vetëm në një periudhë të mbajtjes në masën e

ndalimit nga policia, por nga fakti se ato ishin pjesë e një modeli të përsëritur e të vazhdueshëm dhune për ditë të tëra gjatë marrjes në pyetje që rëndonin situatën.

### **Ç'njerëzore ose poshtëruese**

Keqtrajtimi që nuk konsiderohet si torturë e që nuk ka intensitet ose qëllim të mjaftueshëm për të qenë torturë do të klasifikohet si çnjerëzor ose poshtëruese. Ashtu si me të gjithë këndvështrimet mbi Nenin 3, vlerësimi i kësaj shkalle minimale të ashpërsisë është relative<sup>8</sup>.

Trajtim është konsideruar nga Gjykata si “çnjerëzor” sepse ndërmjet të tjerash duhet të ishte i paramenduar, ishte zbatuar për disa orë me radhë dhe kishte shkaktuar si, dëmtime të dukshme trupore ose vuajtje intensive fizike e mendore. Shumë raste të trajtimit çnjerëzor hasen në kuadrin e ndalimit, ku viktimat i janë nënshtruar keqtrajtimit i cili ka qenë i rëndë, por jo me intensitetin e kërkuar që ky keqtrajtim të cilësohet si torturë.

Ky trajtim mund të zbatohet gjithashtu në një sërë sjelljesh jashtë masës së ndalimit ku viktimat kanë qenë të ekspozuara ndaj akteve të qëllimshme mizore që i kanë lënë ata në stres të jashtëzakonshëm, psh shkatërrimi i banesave në zona ku kryhen operacione ushtarake ne Tuqi.

Trajtimi poshtëruese është ai që konsiderohet se shkakton tek viktimat ndjenja frike, ankthi dhe inferioriteti, në gjendje që t'i përuhin e poshtërojnë ata. Ky lloj trajtimi përshkruhet gjithashtu se përfshin edhe trajtimin që çon në thyerjen e rezistencës fizike ose morale të viktimës<sup>9</sup>, ose që bën që viktima të veprojnë në kundërshtim me vullnetin apo ndërgjegjien e vet<sup>10</sup>.

Faktorë të tillë përkatës si mosha dhe seksi i viktimës mund të kenë një impakt më të madh në vlerësimin e faktit nëse trajtimi është poshtëruese. Në kontrast me faktin nëse trajtimi është çnjerëzor ose përbën torturë, vlerësimi i faktit nëse një individ i është nënshtruar trajtimit poshtëruese është më subjektiv. Në këtë kontekst, Gjykata ka deklaruar se mund të jetë shumë e mjaftueshme që viktima të turpërohet në sytë e tij, edhe nëse jo në sy të të tjerëve.

### **Neni 3 në kontekstin e Konventës**

Gjykata ka renditur shpesh e në mënyrë të përsëritur Nenin 3, ndalimin e torturës dhe trajtimin çnjerëzor, së bashku me Nenin 2, të drejtën për jetën, si një nga të drejtat më themelore që mbrohen nga Konventa, qëllimi thelbësor i së cilës është që të mbrojnë dinjitetin e një individi e integritetin e tij fizik.

Neni 3, jo si disa nene të tjera të Konventës, ku si shembull mund të përmenden Nenet 8 dhe 11, deklarohet në terma absolutë dhe të pacilësuar, pa një paragraf të dytë që të

<sup>8</sup> *Tekin kundër Turqisë*, gjykimi i 9 Qershorit 1998, KEDNJ 1998-IV, 52.

<sup>9</sup> *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, faqja 66,

<sup>10</sup> Opinioni i Komisionit mbi ceshtjen *Greece*

parashtrijë rrethanat kur është e lejueshme përfshirja e torturës, trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor apo poshtërues. Kështu nuk ka vend për kufizime me ligj të kësaj dispozite.

Termat e pakushtëzuar të Nenit 3 gjithashtu nënkuptojnë se asnjëherë, në bazë të Konventës ose të së drejtës ndërkombëtare, nuk do të ketë justifikim për aktet që çenojnë këtë nen. Me fjalë të tjera, nuk mund të ketë faktorë që trajtohen nga një sistem ligjor vendas (ndonjë rrethanë e jashtme apo faktorë të tjerë) si justifikim për një alternativë ndaj sjelljes që ndalohej – jo ndaj sjelljes së viktimës, por sjelljes së shkelësit të ligjit për të vazhduar hetimet ose parandaluar kryerjen e një krimi.

Gjykata ka përsëritur shpesh se edhe në rrethanat më të vështira, si për shembull, në luftën kundër terrorizmit dhe krimin të organizuar, Konventa ndalon në terma absolutë torturën dhe trajtimin apo dënimin çnjerëzor apo poshtërues. Nëse një individ ka kryer apo jo një vepër penale terroriste ose ndonjë vepër tjetër të rëndë, ose nëse dyshohet për kryerjen e një veprë të tillë, nuk përbën fakt për marrjen e vendimit që një keqtrajtim që i është shkaktuar atij personi çënon ndalimin kundër keqtrajtimit.

Gjykata njeh faktin se ka vështirësi të padiskutueshme që janë pjesë e lufës kundër krimin, veçanërisht në lidhje me krimin e organizuar dhe terrorizmin. Ajo njeh gjithashtu nevojat e hetimit për krime të tilla. Në këtë kuadër, Gjykata pranon se në ndjekjen penale të krimeve të tilla mund të lejohen disa përjashtime nga rregulli për provat dhe të drejtat proceduriale. Megjithatë, po këto vështirësi në asnjë mënyrë nuk mund të çojnë në vënien e kufijve për mbrojtjen që sigurohet në lidhje me integritetin fizik të individëve. Ndalimi, si alternativë ndaj keqtrajtimit gjatë marrjes në pyetje dhe intervistave, së bashku me ndalimin mbi përdorimin e provave të marra nga ndalimi për sjelljen përkatëse mbetet absolut<sup>11</sup>.

Po kështu, pavarësisht nga krimet që mendohen se mund të kryhen, shtetet nuk lejohen të sanksionojnë apo imponojnë ndëshkime me motivin që këto masa do të kishin efekte parandaluese kur ndëshkimet mund të binin ndesh me Nenin 3. Nëse burgimi i nënshtrohet kushteve të rrepta ose përfshirjes së një dënimi që shkon përtej burgimit, këto kushte duhet të merren në shqyrtim për pajtueshmëri me Nenin 3.

Ndalimi absolut në Nenin 3 gjithashtu nënkupton se nuk lejohet që të devijohet nga ndalimi edhe në kohë lufte. Ndërsa Neni 15 i Konventës lejon shtetet që në kohë lufte dhe në emergjencë të tjera publike të devijojnë deri në masën e duhur nga standarti që zbatohet normalisht në mbrojtjen e garantuar nga shumica e neneve të Konventës dhe protokollit e saj, nuk ka asnjë dispozitë që lejon devijimin nga Neni 3.

Por në fakt, Neni 15.2 qartëson se edhe në rastet e gjendjeve të jashtëzakonshme ku kërcënohet jeta e një kombi, shteti që ka nënshkruar Konventën nuk lejohet që të keqtrajtojë individët në asnjë mënyrë në bazë të ndalimit që sigurohet nga Neni 3. Asnjë nivel konflikti ose dhune terrorizmi nuk e zbeh të drejtën e individëve për të mos u keqtrajtuar.

---

<sup>11</sup> *Tomasi kundër Francës*, gjykimi i 27 Gushtit 19 92, Seria A nr. 241-A 115.

Kjo gjë ka efekte jashtë-territoriale në mënyrë të pakushtëzuar. Këto efekte shtrijnë mbrojtjen ndaj individëve që të mos ekspozohen ndaj keqtrajtimit përtej territorit të një shteti anëtar, dhe ndaj individëve për të cilët shteti anëtar nuk është përgjegjës. Ka një numër çështjesh që trajtojnë zbatimin e Nenit 3 në rastet e dëbimit apo nxjerrjes jashtë të individëve. Në këto çështje, edhe kur mund të ketë faktorë si për shembull një traktat paraprak mbi ekstradimin, nevoja për të sjellë përpara drejtësisë terroristë të dyshuar që janë arratisur nga një juridiksion i dhënë ose nga vetë sigurimi kombëtar i shtetit dëbues, nuk mund t'a lirojë nga përgjegjësia një shtet për të mos dërguar një individ në një shtet tjetër kur ky individ përballlet me një rrezik real për keqtrajtim.

Së fundmi, duhet vërejtur fakti se ndalimi absolut zbatohet njësoj në çështjen e trajtimit të personave të ndaluar me motive mjekësore dhe/ose që i nënshtrohen trajtimit mjekësor.

### **Ndalimi me motive mjekësore**

Në veçanti, për të përcaktuar nëse trajtimi ose dënimi bie në kundërshtim me standartet e Nenit 3, në rastet e personave me sëmundje mendore, duhet të merret parasysh shkalla e sëmundjes së tyre dhe e dobësisë së tyre në disa raste për të bërë ose jo ankim me baza ligjore mbi mënyrën sesi ka ndikuar tek ata cilido trajtim i caktuar<sup>12</sup>.

Në një çështje kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata konstatoi se mungesa e një monitorimi efikas të kushteve ku mbahej viktimat dhe mungesa e të dhënave informuese mbi gjendjen psikike të viktimës për të përcaktuar gjendjen e trajtimit e duhur rezultoi në zbulimin e difekteve të konsiderueshme në kujdesin shëndetësor që i ishte dhënë personit të sëmurë mendërisht, i cili njihej se ishte potencial për të kryer vetëvrasje. Imponimi i vonuar mbi të i një ndëshkimi të rëndë disiplinor – izolim prej shtatë ditësh i ndëshkimit, dhe një shtesë prej 28 ditësh që iu shtuan dënimit të tij, që u imponuan dy javë pas ngjarjes, dhe vetëm nëntë ditë përpara ditës që pritej për lirimin e tij – ishin mjaftueshëm për të kërcënuar rezistencën e tij fizike dhe morale, dhe nuk ishte në përputhje me standartin e trajtimit të kërkuar në lidhje me një person të sëmurë mendërisht. Gjykata konstatoi se çështja duhet konsideruar se përbën trajtim çnjerëzor e poshtëruar e ndëshkues brenda kuptimit të Nenit 3 të Konvetës<sup>13</sup>.

Por, standartet e trajtimit të pranuar të pacientëve me sëmundje mendore gjithashtu janë në zhvillim e sipër. Duhet kushtuar vëmendje e veçantë kur përcaktohet marrja e masave me instrumentë të kufizimit fizik – si për shembull vënia e prangave ose lidhja me rrip ose përdorimi i këmishës së forcës, etj. Ky tip kufizimi do të justifikohet vetëm në raste shumë të rralla, dhe një sistem ligjor që lejon përdorimin e rregullt të teknikave të tilla, ose kur një përdorim i tillë nuk urdhërohet shprehimisht nga një doktor ose paraqitet menjëherë përpara një doktori me qëllim që të kërkohet miratimi i tij, ka të ngjarë që të shkaktojë probleme përsa i përket pajtueshmërisë me Konventën.

---

<sup>12</sup> *Herczegfalvy kundër Austrisë* gjykimi i 24 Shtatorit 1992, Seria A nr. 244, 82; *Aerts kundër Belgjikës*, gjykimi i 30 Korrikut 1998, Raporte 1998- V, p. 1966, 66

<sup>13</sup> *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, gjykimi i 3 Prillit 2001



### **Efekti Drittwirkung**

Vitet e fundit një numër çështjesh që janë paraqitur para Gjykatës kanë përfshirë shkaktimin e trajtimit poshtëruës ose çnjerëzor ndaj individëve, por më shumë ndaj individëve privatë sesa ndaj një agjenti të Shtetit.

Kur shqyrton këto çështje Gjykata parashtron sesa i gjerë është Neni 3 dhe gjithashtu nxjerr në pah një nga fushat që duhet të përballen detyrimet pozitive të Nenit 3. Këto lloj situatash nxjerrin në pah përgjegjësinë që i imponohet Shtetit për të vënë në zbatim masa parandaluese dhe mekanizma që të sigurojnë me të vërtetë mbrojtjen e individëve ndaj trajtimit çnjerëzor, cilido qoftë burimi i atij keqtrajtimi.

Në një çështje të fundit në Mbretërinë e Bashkuar një djalë i ri ishte rrahur keq nga njerku i tij . Njerku u akuzua në gjykata për dhunë ndaj djalit; megjithatë, ligji në Mbretërinë e Bashkuar lejonte që një prind të kërkonte mbrojtjen sipas parimit të “ndëshkimit prindëror”, kur ishte ngritur një akuzë për ushtrim dhune nga një prind mbi një femijë. Femija dhe babai i tij kundërshtuan ligjin përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut duke vënë në dukje se në fakt ky rast tregonte dështimin për të të patur një sistem ligjor që siguron mbrojtjen e individëve ndaj trajtimit të ndaluar. Gjykata ra dakort me viktimën dhe vërejti se shtetet duhet të marrin masa të tilla që të sigurojnë që individët të cilët janë brenda juridiksionit të tyre të mos i nënshtrohen torturës ose trajtimit apo dënimit çnjerëzor apo poshtëruës<sup>14</sup>.

Po kështu, në disa çështje të fundit Gjykata ka bërë të qartë se shtetet duhet të marrin masa me qëllim që të sigurojnë që individët brenda juridiksionit të tyre të mos i nënshtrohen torturës ose trajtimit çnjerëzor apo poshtëruës, duke përfshirë keqtrajtimin e ushtruar nga individët privatë. Këto masa duhet të sigurojnë mbrojtje efektive, në veçanti të femijëve dhe personave të tjerë vulnerabël e të përfshije në masat e duhura për të parandaluar keqtrajtimin.

### **Hetimi për akuzat mbi ushtrimin e torturës**

Standarti që ka miratuar Gjykata në vlerësimin e provave mbi shkeljet e Nenit 3 është që ato të jenë “përtej dyshimit të arsyeshëm”. Prova të tilla mund të vijojnë nga bashkë-ekzistenca e ndërhyrjeve mja\_ ueshmërisht të forta, të qarta e të përputhshme, ose nga prezumimet e ngjashme e të pamohueshme të fakteve<sup>15</sup>.

Kur autoritetet vendase ngarkohen me detyrën e hetimit mbi incidentet e pretenduara të ushtrimit të torturës ose trajtimit çnjerëzor, barra e provës zakonisht do të varet nga fakti nëse hetimi bëhet brenda sferës penale, apo në kontekstin civil. Për shembull, Gjykata ka bërë të qartë se kur një individ që arrestohet nga policia, i cili gëzon shëndet të mirë,

---

<sup>14</sup> *A kundër Mbretërisë së Bashkuar* gjykimi i 23 Shtatorit 1998, 1998-VI, 22.

<sup>15</sup> *Irlanda*, paragrafi 161.

konstatohet se është dëmtuar në kohën e liritimit, barra i takon autoriteteve për të siguruar një shpjegim të besueshëm në lidhje me shkaktimin e demit<sup>16</sup>.

Përsa i përket hetimit, duke u bazuar në Nenin 2, hetimi mbi akuzën e ushtrimit të tortures apo trajtimit çnjerëzor duhet të mundësojë që të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës. Në të kundërt, ndalimi i përgjithshëm ligjor mbi torturën dhe trajtimin apo dënimin çnjerëzor dhe poshtërues do të bëhet joefikas në praktikë, pavarësisht nga rëndësia e vetë themelore, e do të mundësojë që me raste, agjentët e Shtetit të abuzojnë me të drejtat e personave që janë nën kontrollin e tyre duke i akuzuar pa shkak.

Personat që merren me shqyrtimin e hetimeve duhet të sigurojnë që:

- Prokurorët publikë ose nëpunësit hetues nuk do të përjashtojnë, ose nuk do të pengohen të marrin në pyetje apo të marrin deklarata nga anëtarët e forcave të sigurimit ose të policisë në lidhje me akuzat për keqtrajtim.

- Prokurorët publikë, ose nëpunësit hetues të ndërmarrin hapat e duhur për të verifikuar materialet e dokumentuara që mund të keqtrajtim, për shembull, regjistrimet gjatë ndalimit, ose të hetojnë mbi ndonjë kundërshtim ose mospërputhje apo boshllëk në informacionin e dhënë nga policia apo forcat e sigurimit.

- Prokurorët të ndërmarrin hapa për të kërkuar prova të pavarura mbështetëse, duke përfshirë provat e dhëna në lidhje me akuzat për ushtrim torture. Në çështjen e *Aydin kundër Turqisë*, megjithëse kërkuesja kishte parashtruar ankimin se ishte përdhunuar gjatë ndalimit të saj, prokurori publik dështoi në ndërmarrjen e kontrollit të duhur mjekësor, duke e dërguar viktimën që të bënte testin mbi virgjërinë e saj, në vend të një testi për të përcaktuar provat e ushtrimit të dhunës seksuale.

- Prokurorët të mos lejojnë krijimin e vonesave përpara se të kërkojnë provat ose deklaratat nga kërkuesit apo dëshmitarët.

- Prokurorët të reagojnë menjëherë ndaj shenjave të dukshme të keqtrajtimit ose ankesave mbi keqtrajtim. Në *Aksoy kundër Turqisë*, megjithëse Prokurori Publik mund të ketë parë dëmet e mëdha fizike të shkaktuara mbi kërkuesin, nuk reagoi ndaj një keqtrajtimit të tillë.

- Prokurorët publikë të ndjekin hetimet kundër shkelësve të ligjit që janë agjentë të Shtetit në mënyrën e duhur dhe aktive. Në disa raste, në vend që të ndjekin personat që kanë ushtruar torturë, prokurorët publikë kanë zgjedhur që të akuzojnë viktimën e pretenduar të ushtrimit të dhunës. Për shembull, në *Ilhan kundër Turqisë*, ku kërkuesi ishte dëmtuar fizikisht gjatë arrestimit, ai u procedua sepse nuk kishte ndaluar me urdhërin e forcave të sigurimit, ndërsa nuk u ndërmor asnjë masë ndaj forcave të sigurimit që e keqtrajtuan atë.

- Prokurorët publikë të mos bëjnë diferencime ose të shfaqin qëndrime të kufi zuara ndaj anëtarëve të ushtruesve të ligjit ose forcave të sigurimit me tendencën për të injoruar, ose mos marrë në konsideratë akuzat mbi keqtrajtimet e kryera nga ata. Në veçanti, prokurorët publikë nuk duhet të bëjnë hamendësime se agjentët e Shtetit kanë të

---

<sup>16</sup> *Tomasi kundër Francës* gjykimi i 27 Gushtit 1992, Seria A nr. 241-A, pp. 40-41, 108- 111; *Ribitsch kundër Austrisë* gjykimi i 4 Dhjetorit 1995, Raporte 1996, faqja 26, 34; *Aksoy kundër Turqisë* gjykimi i 18 Dhjetorit 1996, faqja 17, 61.

drejtë, dhe se çfarëdo shenje keqtrajtimit është si rezultat i veprimeve të ligjshme, ose që është ushtruar për shkak të sjelljes së personit që ka parashtruar ankesën.

Një fushë tjetër ku hetimi mbi standartet e zbatuara në shqyrtimin e një çështjeje duhet të jetë i një shkalle të lartë është fusha e ekzaminimeve mjekësore dhe ligjore. Duke qënë se nxjerrja e raporteve të besueshme mjekësore mund të përbëjë faktorin vendimtar midis dy historive të ndryshme mbi një çështje të dhënë, është e rëndësishme që prova të mos jetë vetëm e disponueshme, por gjithashtu e pavarur dhe e plotë.

### **NENI 3 I KONVENTËS EUROPIANE DHE SHOIPËRIA**

#### ***GRORI v Shqipërisë***

129. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, gjykata vë re se provat nga burimet e ndryshme mjekësore konfirmojnë se ankuesi kishte probleme të shumta mjekësore që kërkonin ndihmë të rregullt mjekësore. Gjithsesi, asgjë nuk sugjeronte se sëmundjet e tij ishin në parim të papërputhshme me burgimin. Burgu kishte një njësi mjekësore, ku ankuesi ishte vizituar në shumë raste, dhe sëmundja e tij prezumohet të mund të ishte trajtuar në atë njësi.

130. Në të njëjtën kohë, gjykata i referohet vëzhgimeve të saj se ankuesi nuk e kishte marrë ndihmën e nevojshme ligjore (shih paragrafët 121 dhe 122 më lart). Edhe ndërsa ishte në spitalin e burgut, ai vuante qartë nga efektet fizike të kushteve të tij mjekësore. Në lidhje me efektet mendore, ai mund të ketë ditur se ishte në rrezik të një emergjence mjekësore në çdo moment, emergjencë me pasoja serioze dhe se nuk kishte ndihmë të kualifikuar mjekësore të disponueshme. Ankuesit jo vetëm që iu refuzua ndihma e nevojshme mjekësore nga auto ritetet, por ai u vendos në një regjim të sigurisë së lartë, duke iu mohuar mundësia për të kontaktuar me përfaqësuesin e tij (shih paragrafin 56 dhe 57 më lart). Kjo mund të ketë çuar në një ankth të konsiderueshëm në anën e tij.

131. Gjykata nuk mund të pranojë argumentin e qeverisë se trajtimi i ankuesit me interferon beta do të ngarkonte rëndë Buxhetin e Shtetit. Ndërsa gjykata nuk nënvlerëson vështirësitë financiare të qeverisë, ajo thekson se ky medikament ofrohet pa pagesë për publikun në spitale. Qeveria nuk dha asnjë arsye legjitime për të justifikuar heqjen e së drejtës së ankuesit, ndryshe nga anëtarët e tjerë të publikut, për t'iu përmbushur kostot e medikamenteve të tij plotësisht nga shteti përkatës të.

132. Ankuesi vuante nga një sëmundje shumë e rëndë, nga multiskleroza. Edhe nëse zbulohet dhe trajtohet shpejt, kjo sëmundje është e aftë të shkaktojë paaftësi (njohëse, gjykuese, dhe çrregullime kujtese, probleme në lëvizje, dhimbje, kushte të varfra dhe mosfunksionim të muskujve unazorë) dhe vdekje. Rreziku i sëmundjes, i shoqëruar me mungesën e trajtimit të përshtatshëm mjekësor dhe kohëzgjatja e kohës së burgimit, e intensifikuan frikën e tij. Në këto rrethana, mungesa e ndihmës mjekësore në kohën e duhur, që i shtohet refuzimit të autoriteteve për t'i ofruar atij trajtimin e duhur mjekësor të

dhënë nga mjekët civilë, krijuan një ndjenjë kaq të fortë mungese sigurie, e cila, e kombinuar me vuajtjet fizike, çojnë në trajtimin degradues të parashikuar në kuptimin e nenit 3.

133. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në këtë aspekt.

### ***DYBEKU v Shqipërisë***

36. Gjykata rithekson se, sipas jurisprudencës së saj, trajtimi i sëmundjes duhet të prekë nivelin minimal të kushteve të vuajtjes së dënimit, në mënyrë që të jetë brenda kuptimit të nenit 3 të Konventës. Vlerësimi i këtij niveli minimal të vuajtjes së dënimit është relativ: ai varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, siç është kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike dhe mendore dhe në disa raste varet nga seksi, moshja dhe gjendja shëndetësore e viktimës

Megjithatë sipas këtij neni, shteti duhet të garantojë që një person të dënohet në kushtet të cilat janë në pajtim me dinjitetin njerëzor, që mënyra apo metoda e ekzekutimit të këtyre masave të mos e nënshtrojnë atë ndaj ankthit apo mundimit të një intensiteti të tillë që e kapërcen nivelin e pashmangshëm të vuajtjes e cila është prezent në burg, dhe sipas kërkesave praktike të burgimit të sigurohen në mënyrë të përshtatshme shëndeti dhe mirëqenia e tij.

41. Megjithatë neni 3 i Konventës nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që të parashikojë një detyrim të përgjithshëm për lirimin e të dënuarve nisur nga shkaqet shëndetësore, por ky nen u vë detyrimin shteteve për të mbrojtur mirëqenien fizike të personave me liri të kufizuar, për shembull duke u dhënë atyre ndihmën e duhur

42. Tri janë elementet e veçanta të cilat duhet të merren parasysh në lidhje me pajtueshmërinë e gjendjes së ankuesit për sa i takon me qëndrimin të tij në burg: a) kushtet mjekësore të të burgosurit; b) përshtatshmëria e ndihmës dhe e përkujdesit mjekësor të parashikuar në burg dhe c) garantimi i masave të burgimit në përputhje me gjendjen shëndetësore të

45. Sipas autoriteteve, nisur nga pamundësia e sigurimit të trajtimit të duhur mjekësor për ankuesin, për shkak të mungesës së institucioneve përkatëse dhe medikamenteve (shih paragrafin 34 më sipër), ai ishte trajtuar me ilaçe të ngjashme me ato të rekomanduara nga mjeku i tij dhe deri në ngritjen e një institucioni psikiatriko-penal të specializuar, ai ishte vendosur në një qeli me ajrim dhe me ndriçim të mirë, në një burg të sigurisë së lartë, të cilën ai e ndante më të burgosur të tjerë, të cilët ishin në gjendje të mirë shëndetësore. Ai kishte marrë trajtim si pacient i spitalit të burgut të Tiranës vetëm kur gjendja e tij ishte përkeqësuar.

46. Babai dhe avokati i ankuesit paraqitën një sërë ankesash para autoriteteve kompetente kundër administratës së spitalit të burgut dhe repartit mjekësor, duke pretenduar që ata kishin neglizhuar duke mos arritur të rekomandojnë trajtimin e përshtatshëm mjekësor

dhe se gjendja e tij ishte përkeqësuar për shkak të mungesës së trajtimit dhe ekzaminimit mjekësor. Megjithatë, të gjitha ankesat e tyre nuk u morën parasysh. Në të vërtetë, Gjykata vëren se vlerësimi i fundit mbi gjendjen shëndetësore të ankuesit daton përpara vitit 2002. Të dhënat mjekësore mbi ankuesin tregojnë se atij vazhdueshmërisht i është rekomanduar i njëjti trajtim dhe se nuk është bërë asnjë përshkrim i detajuar mbi zhvillimin e sëmundjes së tij.

47. Gjykata konsideron se fakti që ankuesi ishte deklaruar i përgjegjshëm penalisht për konsumimin e elementeve të veprës penale të vrasjes dhe ishte dënuar me burgim të përjetshëm nuk është vendimtar për sa i përket çështjes, nëse autoritetet i kishin përmbushur detyrimet e tyre sipas nenit 3 për ta mbrojtur atë nga një trajtim apo dënim në kundërshtim me këtë nen. Në të vërtetë, ndjenja e inferioritetit dhe pafuqishmëria, e cila është tipike për personat të cilët vuajnë nga çrregullime mendore, kërkon një vëmendje të madhe për të parë nëse Konventa është respektuar. Ndërkohë që është detyrë e autoriteteve të vendosin mbi bazën e rregullave të njohura të shkencës së mjekësisë, në lidhje me metodat terapeutike që duhet të përdoren për të trajtuar gjendjen fizike dhe mendore të personave të paafte për të vendosur për veten e tyre dhe për të cilët këto autoritete janë të përgjegjshme, sërish këta persona mbeten nën mbrojtjen e nenit 3, kërkesat e të cilëve nuk e lejojnë përjashtimin nga ky nen.

48. Gjykata pranon që natyra e kushteve psikologjike të ankuesit e bëri atë më shumë të prekshëm sesa mesatarja e të dënuarve të tjerë dhe se burgimi i tij mund të ketë acaruar në një nivel të caktuar ndjenjat e tij të ankthit, vuajtjes dhe frikës. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se fakti që pala shqiptare e pranoi që ankuesi ishte trajtuar si të burgosurit e tjerë, pavarësisht gjendjes së tij shëndetësore të veçantë, tregon mungesën e angazhimit të tyre për përmirësimin e kushteve të vuajtjes së dënimit në pajtim me rekomandimet e Këshillit të Europës (shih paragrafin 18 më sipër).

50. Gjykata nuk e nënvlerëson rëndësinë e vështirësive financiare të referuara nga pala shqiptare (shih paragrafin 33 më sipër). Megjithatë, ajo vëren se shumë prej mangësive të identifikuara më sipër mund të ishin ndrequr edhe në mungesën e mjeteve financiare të konsiderueshme. Në çdo rast, mungesa e burimeve financiare nuk mundet të justifikojë kushte të tilla vuajtje dënimi, të cilat janë kaq të varfra sa prekin nivelin minimal të vuajtjes së dënimit të parashikuar nga neni 3, duke bërë që ai të zbatohet në këtë rast,

52. Pra është shkelur neni 3 i Konventës.

### **VENDIM NR. 3, DATË 11.2.2004 I GJYKATES KUSHTETUESE**

4. Krahas këtij trajtimi doktrinar dhe evolutiv që vihet re në jurisprudencën ndërkombëtare argumenta tepër të rëndësishme për të konkluduar për zgjidhjen e çështjes konkrete gjenden edhe në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në çështjen *A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ajo konkludon se “detyrimi i shteteve anëtare nga neni 1 i Konventës për t’i siguruar kujtdo që është nën juridiksionin e tij të drejtat

*dhe liritë e shprehura në Konventë e kombinuar së bashku me nenin 3 të saj, i kërkon shteteve anëtare të marrin masa të përcaktuara për të siguruar se individët nën juridiksionin e tyre nuk janë subjekt i torturës apo keqtrajtimit çnjerëzor degradues duke përfshirë edhe keqtrajtimet e kryera nga individët privatë”.<sup>17</sup> Pikërisht bazuar mbi një konkluzion të tillë, dështimi që mund të vihet re në ligjet e brendshme të shteteve të ndryshme për të siguruar një mbrojtje adekuate përbën shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>18</sup>*

Nisur nga kjo analizë me karakter interpretues, bazuar edhe në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese konkludon se për sa kohë që ndalimi i torturës dhe keqtrajtimit është përcaktuar si një e drejtë njerëzore dhe përderisa të drejtat e njeriut janë konsideruar si të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme, çdonjeri ka të drejtë për të mos iu nënshtruar torturës apo keqtrajtimeve, pavarësisht se ai është në duart e një zyrtari publik apo të një individ. Detyrimi i shteteve palë në marrëveshjet ndërkombëtare për të respektuar e siguruar ndalimin e torturës dhe keqtrajtimit konsiston jo vetëm në detyrimin e shtetit për të mbrojtur shtetasit e tij nga kryerja e torturës apo keqtrajtimit nga zyrtarët publik, por edhe në detyrimin për të marrë masa për t'i mbrojtur njerëzit ndaj akteve të torturës apo keqtrajtimit të kryer edhe nga individë.

Nga sa argumentuam më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 86 dhe 87 të Kodit Penal, është e pabazuar dhe për rrjedhojë duhet rrëzuar.

---

<sup>17</sup> A. v. Mbretërisë së Bashkuar, para 21.

<sup>18</sup> Kjo gjykatë në një çështje analoge ka nënvizuar se “përgjegjësia e shtetit... mund të jetë kur kuadri ligjor dështon për të siguruar një mbrojtje adekuate ose kur autoritetet dështojnë të marrin masa të arsyeshme për të shmangur rrezikun e keqtrajtimit kur e dinin ose duhet ta dinin këtë rrezik.”. Mahmut Kaya. v. Turqisë, para 115.